

[Data 11/11/2024]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE PAJISJE SPECIALE PËR MZSH-NË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje shpëtimi ose emergjence - 35112000-2; Pajisje zjarrfikëse, shpëtimi dhe sigurie 35110000-8

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **22,491,433.3** (njëzet e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e tre pikë tre) pa TVSH.

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 11/11/2024 është 98.13 Lekë/Euro.**

Burimi i financimit: VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024”, i ndryshuar.

Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

1. Bazuar në Nenin 61 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur, siç është rasti i blerjes së mallrave “Blerje pajisje për zyrat”. Gjithashtu kjo zgjedhje e marrëveshjes kuadër me 1 Operator ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për këtë procedurë prokurimi, është se objekti i prokurimit parashikon një furnizim periodik dhe të vazhdueshëm dhe për këtë arsye realizimi nga operatorë ekonomik të ndryshëm nuk është i favorshëm duke i shkaktuar vështirësi autoritetit kontraktor. Bazuar dhe në rekomandimet e APP-së, është përzgjedhur lloji i Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Kryerja e furnizimit të kërkuar nga AK nga operatorë të ndryshëm ekonomikë nuk do të ishte i favorshëm, pasi do të shoqërohej me kosto shtesë dhe vonesa të furnizimit me pajisjet objekt prokurimi.

2. Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE ku të gjitha kushtet nuk janë të përcaktuara do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri nga ana e AK lidhur me cilësinë e pajisjeve, që në rastin konkret duhet të jenë me të njëjtin material dhe të së njëjtës linje prodhimi. Në rast të kundërt, ofrimi i pajisjeve nga OE të ndryshëm pas rihapjes së minikonkurseve, mund të sillte për pasojë furnizim me pajisje që mund të mos kenë të njëjtin material dhe linjë nga njëri furnitor të tjetri.

3. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për realizimin e furnizimit në kohën e kërkuar nga AK. Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështime në realizimin e suksesshëm të kontratës. Me qëllim garantimin e kryerjes së furnizimit me pajisje në afatet kohore të përcaktuara për AK përfitues, MK me një OE të vetëm do të garantonte sigurinë e kryerjes së investimit, sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: Afati kohor i parashikuar për realizimin e objektit të prokurimit është 12 (dymbëdhjetë) muaj. Data e fillimit të implementimit të kontratës/kontratave është data e nënshkrimit dhe periudha e parashikuar për realizimin e saj/tyre është 30 (tridhjetë) ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës. Përgjatë periudhës një mujore të realizimit të kontratës/kontratave, lëvrimi i pajisjeve do të realizohet sipas kërkesave të AK.

Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Pranë magazinës së Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të artikujve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë, pasi do e bënte shumë të vështirë për t’u menaxhuar.

Kjo procedurë furnizimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues, pasi lloji i furnizimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që kjo procedure ka. Ndarja në lote do të sillte konfuzion, pasi të gjithë zërat e kërkuar për furnizimin janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të kryerjes së furnizimit. Për këtë arsye, është e pamundur që artikujt e preventivit të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

- 1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.*
- 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.*
- 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njih gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me një familje artikujsh të vetëm dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetem paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Në varësi të zërave që do të marrin përsipër të mbulojnë apo bashkimin e fuqisë punëtore dhe stafit, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët koktrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njih të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë, për procedurën me objekt **“Blerje Pajisje Speciale për MZSH-në”**.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

d. Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 3

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertave, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur kontratës që prokurohet**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përlllogaritur, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Pika 2/a: dyfishin e vlerës së përlloritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Vlera e përlloritur është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2021, 2022, 2023, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmës “c” te nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit ne Qendren Kombëtare te Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

*** Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920

date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare, si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të para

qesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe neni 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi në përputhje me dispozitat ligjore.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.4 Kërkesa të tjera të vecanta për kualifikim:

2.4.1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

• **Standardi ISO 9001** parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca/profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për furnizim, ofrim shërbimesh dhe për proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit, sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për standardin ISO 9001 ose ekuivalent me të, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës në të gjithë komponentët e saj.

2.4.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/et e prodhues/ve ose distributor/ve të autorizuar për zërat si vijon.

1. Kamera termike;
2. Motopompa portative;
3. Motosharra portative;
4. Aparat frymëmarrje AP3;
5. Tubo zjarrfikëse
6. Dyshek shpetimi
7. Hedhëse zjerrfikëse

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet e dokumentuar lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Shënim: Autorizimi duhet të paraqitet në gjuhën/gjuhët e përcaktuar në DST.

Argumentimi: Referuar nenit 77, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Si dhe pika 4, [...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.]

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

Duke qenë se Autoriteti kontraktor, është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës, volumit dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie të mundshme përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin e shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.

Kjo kërkesë jep garanci më tepër për:

- *Përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes rishitësit/partnerit të autorizuar;*
- *Vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e produktit;*
- *Përmes regjistrimit të të dhënave të prodhuesit, përfitim e mëvonshëm potencial të suportit nga ana e tyre.*

Gjithashtu, ky dokument siguron AK se:

1- Operatori ekonomik ka leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë dhe se janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto mjete.

2- Nëpërmjet informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

3- Operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mjeteve. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e shërbimit dhe llojit të mjetit të ofruar, si dhe përfshirjen e vet shërbimeve dhe suportit të prodhuesit/ distributorit zyrtar në këtë kontratë.

Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi/distributori i autorizuar, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të mjeteve të ofertuara dhe nevojës për garanci mbi efikasitetin dhe kapacitetet teknike të tyre.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në këtë proces. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar që furnizimi me mallra të realizohet me sukses dhe pa probleme të panevojshme.

2.4.3. *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Katalogun /et ose fragmente të katalogut/eve teknike të prodhuesit /ve ku të tregohen karakteristikat teknike të pajisjeve të ofruara, të cilat duhet të përmbushin plotësisht specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 6 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST.*

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) neni 40 pika 6/b, i cili përcakton se :*

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

...b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose”...

Katalogu/fragment katalogut i pajiseve tregon te dhenat teknike lidhur me pajisjet, sikurse jane : lloji i mjetit forma, dimensionit,...etj).

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Së pari, paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth tyre. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë e pajisjeve që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Së dyti, kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që pajisjet e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Kjo do të shërbejë që KVO të gjykojë dhe vlerësojë mbi karakteristikat teknike të pajisjeve të ofertuara bazuar në katalogët përkatës të lëshuar nga prodhuesi nëse ato përputhen apo jo me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Së treti, kriteri lidhur me “Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST“, është vendosur pasi, Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës, pra shqip apo anglisht. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim (shqip apo anglisht).

2.4.4 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë garancie për mallrat e ofertuara, në të cilën të jenë të përcaktuara dhe përshkruara qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi. Periudha e garancisë teknike të fillojë nga data e marrjes në dorëzim të mallrave nga autoriteti kontraktor. Garancia do të jetë 12 muaj nga momenti i dorëzimit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe të mbulojnë detyrimet brenda periudhës së garancisë. Kriteri i kërkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me pikën 8, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.

- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.*

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “Blerje Pajisje Speciale për MZSH-në”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: “Blerje Pajisje Speciale për MZSH-në”, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Bazuar në specifikimet teknike të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për çmimin pajisjeve specialeve, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë “Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën “Blerje Pajisje Speciale për MZSH-në”.

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave për pajisje speciale që kanë strukturat e MZSH-së, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

Specifikimet teknike

Termet e referencës dhe kërkesat funksionale/specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/Grup pune për objektin që prokurrohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse e e dokumentave standarte të tenderit, për procedurën me objekt: “Blerje Pajisje Speciale për MZSH-në” si më poshtë:

1. KAMERA TERMIKE:

Kamera termike për përdorim të shërbimit të MZSH-së gjatë ndërhyrjeve operuese zjarrfikëse. Të jetë sa më kompakte dhe e lehtë, me buton i lehtë për t'u përdorur edhe me doreza, me 2 bateri te rikarikueshme rezistente ndaj temperaturave te larta, rripa anësore, me opsionin e kapjes me dorezë të lëvizshme. E ndërtuar nga materiale që mund të përballojnë temperaturat e larta që hasen në situatat e shuarjes së zjarrit gjithashtu të durojë rrëzimin nga një lartësi të paktën 2m në sipërfaqe të fortë.



Pesha (me 2 bateri dhe rripa anësore)	max. 950 gr
Pesha e dorezës së lëvizshme	max.190 gr
Ekran për dukshmërinë e detajeve	3,5" LCD / 320 x 240 (76 800) px
Koha e punës deri në 6 orë (2 bateri)	
Gama e zbulimit: - 40°C deri +1150°C	

- Regjistrimi i fotografimit (kapaciteti 8 GB)
- Koha e nisjes: më pak se 5 sekonda
- Mbrojtje kundra ujit sipas klases IP67 /1 Metër 30 minuta
- Prova e rënies: të paktën 2 m në sipërfaqe të fortë
- Rezistenca ndaj nxehtësisë 150°C deri 15 min / 260°C deri 5 min
- Karikues per bateri 240 V

2. MOTOPOMPË PORTATIVE:

Pompa të përbëhet nga një material i qëndrueshëm dhe rezistent, e aftë të përballojë ujë që përmban edhe lëndë të ngurta.

Diametri i tubit: Diametri 2" (Inch) ose 52 mm

Lidhja e pershtatshme për lidhje STORZ C

Gjatesia: Min. 520 mm – Max. 620 mm

Gjeresia: Min. 360 mm – Max. 470 mm

Lartësia: Min. 410 mm – Max. 510 mm

Pesha: min 25 kg - max 37 kg

Thithja: min 7 m

Shpejtësia e rrjedhjes: min. 500 l/min

Motorri: nje cilindër, 4 kohesh, me benzine/naftë

Kapaciteti i serbatorit të karburantit: min.3.1 lt - max 4.2 lt



3. MOTOSHARRË:



Motosharrë profesionale për t'u përdorur në operacionet e zjarrfikësve, Të qëndrojnë e ekuilibruar gjatë gjithë përdorimit Të ketë sistem lubrifikimi të tillë që të bëjë lubrifikimin e zinxhirit gjatë përdorimit. Motori të garantojë ndezje të thjeshtë, të shpejtë dhe të lehtë në çdo moment si dhe të jetë në gjendje të funksionojë vazhdimisht për periudha të gjata pa u mbinxehur dhe pa humbur fuqinë, gjatë ndërhyrjeve operuese zjarrfikëse. Performancë motori optimale, ruan ambientin nga lëndët e dëmshme (emetimet) dhe me një ndezje të lehtë në çdo moment
Fuqia min. 4.0 kw - max 4.6 kw

- _____ Pesha min.
6.3 kg - max. 6.8 kg

- Gjatesia e shinës min. 450 mm - max. 530 mm

- Kapaciteti min 71.00 cm³ - max 72.5 cm³

4. TUBO ZJARRFIKËSE: (1 e 1/2" (Inch) ose Φ 38 m)



Tuba zjarrfikëse të veshur me gomë brenda dhe jashtë

Thurja e jashtme dopjo poliestër

Diametri 1 e 1/2" (Inch) ose 38 mm

Gjatesia 1 (një) copë = 20 (njëzet) metër linear

Të dyja krahet me lidhëse të montuara

Lidhëse STORZ material alumin, me gomina për mosrjedhje

Presion pune ≥16 bar

Presioni plasjes të paktën 50 bar

Pesha 300 g/m – 320 g/m

Rezistent ndaj të ftohtit deri në -35°C

Rezistent ndaj nxehtësisë deri në +100°C

Tubat duhet të jenë sipas standartit DIN 14811 Klasa 3 ose ekuivalente

Ngjyra e kuqe ose e verdhë

5. TUBO ZJARRFIKËSE: (Φ52 mm)

Tuba zjarrfikëse të veshur me gomë brenda dhe jashtë

Thurja e jashtme dopjo poliestër.

Diametri 2" (Inch) ose 50-52 mm
Gjatësia 1 (një) copë = 20 (njëzet) metër linear
Të dyja krahët me lidhëse të montuara
Lidhëse STORZ, material alumin, me gomina për mosrjedhje
Presion pune ≥ 16 bar
Presioni plasjes të paktën 50 bar
Pesha 400 g/m – 420 g/m
Rezistent ndaj të ftohtit deri në -35°C
Rezistent ndaj nxehtësisë deri në $+100^{\circ}\text{C}$
Tubat duhet të jenë sipas standartit DIN 14811 Klasa 3 ose ekuivalente
Ngjyra e kuqe ose e verdhë

6. TUBO ZJARRFIKËSE: ($\Phi 75$ mm)

Tuba zjarrfikëse të veshur me gomë brenda dhe jashtë
Thurja e jashtme dopjo poliestër.
Diametri 3" (Inch) ose 75 mm
Gjatësia 1 (një) copë = 20 (njëzet) metër linear
Të dyja krahët me lidhëse të montuara
Lidhëse STORZ, material alumin, me gomina për mosrjedhje
Presion pune ≥ 16 bar
Presioni plasjes të paktën 50 bar
Pesha 690 g/m – 710 g/m
Rezistent ndaj të ftohtit deri në -35°C
Rezistent ndaj nxehtësisë deri në $+100^{\circ}\text{C}$
Tubat duhet të jenë sipas standartit DIN 14811 Klasa 3 ose ekuivalente
Ngjyra e kuqe ose e verdhë

7. BARELA: (Scoop stretcher)



Korniza: Alumini

Materiali: PVC

2 rripa sigurie

Pesha e produktit: 11 kg

Toleranca e peshës: 159 kg

8. JASTËK AJRI PËR SHPËTIMIN/DYSHEK SHPËTIMI:



Jastëku i ajrit për shpëtimin/Dysheku i shpëtimit ofron një zgjidhje të sigurt dhe efikase për shpëtime emergjente si zjarre të mëdha, sulme terrorizmi, tërmete etj.
Dysheku i shpëtimit është i përshtatshëm për njerëzit që kërcëjnë nga pozicione të larta në situata emergjente

shpëtimi.

Të dhëna teknike

- a) Lartësia e rënies nuk duhet të kalojë 16 m.
- b) Përmasat pas fryrjes: min.3x3x1.5m max.4x4x2m
- c) Duhet te jete i pajisur me tub dhe cilinder me ajër të kompresuar 6.8L/300 bar
- d) Koha e fryrjes së parë maksimumi 40 sekonda dhe rifryrje pas cdo hedhje koha maximale 20 sekonda
- e) Pjesa e sipërme duhet të jetë reflektuese për të lehtësuar dukshmërinë natën.
- f) Material i papërshkueshëm nga uji, antiacid, rezistent ndaj grisjes dhe gërryerjes
- g) Jastëku i ajrit për shpëtimin të jetë i çertifikuar sipas standartit DIN 14151 T1 T3 ose ekuivalente

9. HEDHËSE ZJARRFIKËSE: (Φ52 mm)



Tipi - Turbojet
Diametri 2" (Inch) ose 50-52 mm
Sprucator me hedhje të regjistrueshme
Me 4 pozicione për regjistrimin e llojit të hedhjes
Me dorezë për regjistrimin e sasisë
Me dorezë mbajtëse alumini
Presioni i punës minimumi 6 bar
Fluksi i rrjedhjes se ujit min. 115 litra/min dhe max 475 litra/min

Krahu i furnizimit me lidhëse të montuar STORZ, material alumin, me gominë për mosrrjedhje
Pesha jo me e madhe se 2.5 kg
Përmasat: min.262x115x242 mm max.268x120x248mm

10. HEDHËSE ZJARRFIKËSE: (Φ75 mm)



Tipi - Turbojet
Diametri 3" (Inch) ose 75 mm
Sprucator me hedhje të regjistrueshme
Me 4 pozicione për regjistrimin e llojit të hedhjes
Me dorezë për regjistrimin e sasisë
Me dorezë mbajtëse alumini
Presioni i punës minimumi 6 bar
Fluksi i rrjedhjes se ujit min. 115 litra/min dhe max 475 litra/min

Krahu i furnizimit me lidhëse të montuar STORZ, material alumin, me gominë për mosrrjedhje
Pesha jo me e madhe se 2.8 kg
Përmasat: min.262x115x242 mm max.275x120x260mm

11. APARAT FRYMËMARRJE AP3 (KOMPLETI):

Aparat Frymëmarrje AP3 (në anglisht “SelfContained Breathing Apparatus” SCBA) për përdorim të shërbimit të MZSH-së. Aparatet duhet të përmbushin standardet përkatëse evropiane për të garantuar siguri, besueshmëri dhe performancë gjatë ndërhyrjeve operuese zjarrfikëse si dhe të jenë në përputhje me aktet normative në fuqi të Republikës së Shqipërisë

Aparati i frymëmarrjes duhet të jetë në përputhje me standartin EN 137:2006; EN 136; EN 12245:2022 ose ekuivalente të tyre.



Të gjitha pjesët e tij të jenë të ndërtuara nga materiale që mund të përballojnë temperaturat e larta, rezistente ndaj ndikimeve mekanike dhe rezistente ndaj kimikateve të ndryshme si dhe substancave të tjera të rrezikshme që mund të hasen gjatë ndërhyrjeve operuese zjarrfikëse. Parzmore/Shtrati dhe rripat mbajtës

i lehtë për t'u pastruar, i fortë dhe me peshë të lehtë.

riprat me materiale jo-tekstile për të parandaluar kontaminimin dhe të dizajnuara për të qenë në formë trupi për ergonomi të shkëlqyer.

a) _____ rripat të rregullohen lehtësisht për madhësi të ndryshme të trupit në katër parametra të madhësive të ndryshme ("S", "M", "L", "XL").

b) i aftë të mbajë cilindra të ajrit deri në 9 litra

c) të jetë në përputhshmëri me standartin EN137 Type 2 ose ekuivalente

d) pesha max 4.00 kg (pa përfshirë maskën dhe valvulën)

11.1 RREGULLATOR PRESIONI DHE VALVULA DHËNËSE:

Rregullator presioni i aftë të reduktoj presionin e lartë (300 bar) në një nivel të përshtatshëm nga cilindri i ajrit dhe ta përcjellë me anë të tubave të përshtatshëm dhe të fiksuar në shtratin dhe rripat mbajtës për tek valvula dhënëse dhe nëpërmjet saj tek maska, duke siguruar një rrjedhje dhe presion ajri të qëndrueshme dhe të sigurt pavarësisht nga ajri i mbetur në cilindër. Njësia e rregullatorit ka një matës presioni dhe sinjal akustik.

Valvula dhënëse të sigurojë presion pozitiv dhe aktivizim automatik duke rregulluar furnizimin me ajër në maskën e fytyrës me rezistencë sa më të ulët gjatë frymëmarrjes së përdoruesit. Presioni pozitiv aktivizohet automatikisht kur përdoruesi thith për të marrë frymën e parë. Të jetë lehtësisht e ndashme nga maska e fytyrës dhe sistemi i transmetimit të ajrit nga reduktori i presionit me bashkues të shpejt dhe të sigurt.

11.2 MASKA E FYTYRËS:



Maskë e plotë fytyre në përputhje me EN 136 Class 3 ose ekuivalente

Të jetë lehtësisht e ndashme nga valvula dhënëse sipas DIN 58600, të vendoset dhe puthitet mirë dhe të jetë komode në fytyrë me anë të rripave lehtësisht të rregullueshëm. Maska të ofrojë një fushëpamje të gjerë për përdoruesin, të mbajë presion pozitiv brenda pjesës së fytyrës duke siguruar që ajri i kontaminuar jashtë saj të mos hyjë në maskë si dhe të përputhet me pjesët e tjera të Aparatit të Frymëmarrjes. Lidhja e maskës të përshtatet gjithashtu me filtra me lidhje Rd40.

Materiali EPDM
Pesha max. 850 gr

11.3 CILINDRI I AJRIT

Cilindri i ajrit të jetë në përputhje me EN 12245 ose ekuivalente, me një jetëgjatësi sa më të lartë, peshë sa më të lehtë, material kompozit ose të ngjashme, rezistent gjatë ndërhyrjeve operuese zjarrfikëse. Të jetë i pajisur me valvulën e rrjedhjes së tepërt (EFV) e cila mundëson reduktimin e rrjedhës së ajrit nga cilindri në

rast dëmtimi ose hapjeje të paqëllimshme.
volum 6.8 litra
presion pune 300 bar
Pesha bosh max 3.8 kg (përfshirë valvulën)

12. ELEKTRIK DORE ME BATERI TË KARIKUESHME:

Të dhëna teknike:

Certifikimi në përputhje me ATEX

Me kornizë të rrumbullakët fotolumineshente

Mbrojtje kundër ujit sipas klases IP67

Permasat: min.71x69x156mm max.75x73x160mm

Pesha: jo më shumë se 700 g (bateria e përfshirë)

Kohëzgjatja e ndriçimit: modaliteti normal: të paktën 4 orë / modaliteti i kursimit: mbi 15 orë

Materiali: të ketë rezistencë të lartë ndaj goditjeve, temperaturave ekstreme dhe substancave

Bateri e rikarikueshme 3,7 V e përfshirë

Me paralajmërim për baterinë e ulët: SOS Sinjali pulsues i LED kryesor 15 min. para se të mbarojë bateria

Karikues baterie



Shënim: Pas identifikimit të nevojave dhe rishikimit të specifikimeve referuar edhe vendimit nr.845/2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit, kërkesat për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, për objektin e prokurimit, janë hartuar nga Grupi i punës/ struktura e posaçme e përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40 dhe 74 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), për përmbyshjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor.

DST është dërguar pranë KPP, e cila në vendim Nr. 1552/2024 ka lejuar AK të vijojë me publikimin.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje Pajisje Speciale për MZSH-në", Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit

Lista e artikujve

Specifikimet teknike

Sasia dhe grafiku i lëvrimit

NJËSIA E PROKURIMIT